

UDC 351.746.3 (497.115)

351.746.4 (497.115)

Fisnik Sadiku¹

Besnik Lokaj²

**INDUSTRIA E SIGURISË PRIVATE NË EVROPËN JUGLINDORE: RASTI I
KOSOVËS**

**ИНДУСТРИЈАТА НА ПРИВАТНОТО ОБЕЗБЕДУВАЊЕ ВО ЈУГОИСТОЧНА
ЕВРОПА: СЛУЧАЈ КОСОВО**

**THE INDUSTRY OF PRIVATE SECURITY IN THE SOUTHEAST EUROPE – THE
CASE OF KOSOVO.**

Abstrakti

Industria private e sigurisë është një komponent i rëndësishëm i sigurisë dhe sigurimit në Republikën e Kosovës dhe vendet e zhvilluara. Sot, siguria private është përgjegjëse jo vetëm për mbrojtjen e shumë institucioneve të rëndësishme të vendit dhe sistemet kritike të infrastrukturës, por edhe për mbrojtjen e pronës intelektuale dhe informatat e ndjeshme të korporatës. Kompanitë kosovare gjithashtu mbështeten shumë në sigurinë private për një gamë të gjerë funksionesh, duke përfshirë shërbimet themelore të sigurimit, shërbimet e mbrojtjes së afërt, shërbimet e transportit të parave të gatshme, shërbimet e vëzhgimit elektronik të pronës, si dhe shërbimet e sigurimit të tubimeve publike

Ky punim u ofron lexuesve informacione lidhur me infuzionin e industrisë private në fushën e sigurisë private, në njërin nga shtetet me të reja në botë: Republika e Kosovës. Njëkohësisht, punimi që kam zgjedhur për hulumtim, është një studim i pa trajtuar më parë ose shumë pak i trajtuar dhe hulumtuar në literaturën shqipe, edhe pse flitet kalimthi për industrinë e sigurisë private, ato nuk janë të studiuara në mënyrë sistematike. Përveç kësaj, kjo punim ofron një kontribut analitik për privatizimin e sigurisë dhe dallimin në mes të kompanive private të sigurisë, kompanive të kontraktuara ushtarake dhe mercenarëve.

Studimi është bazuar në një gamë të gjerë të literaturës së shkruar dhe elektronike, duke përfshirë literaturën akademike, kërkimore-shkencore, dhe raporte e dokumente nga organizata të ndryshme joqeveritare.

Fjalët kyçe: Republika e Kosovës, sistemi i sigurisë, kompanitë private të sigurisë

Abstract

The private security industry is an important component of security and safety in the Republic of Kosovo and developed countries. Today, private security is responsible not only for the protection of many important institutions of the country and critical infrastructure systems, but also for the protection of intellectual property and sensitive corporate information. Kosovo companies also rely heavily on private security for a wide range of functions, including basic security services, close protection services, cash transportation services, electronic property surveillance services, and security services of public rallies.

¹ Magjistër në Studime të Sigurisë. I punësuar në Policinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës. E-mail: fisniksadiku@gmail.com.

² Magjistër në Studime të Sigurisë. I punësuar në Regjimentin e Mbrojtjes Civile në Forcën e Sigurisë së Kosovës. E-mail: besniklokaj@hotmail.com.

This paper provides readers information regarding infusion of private industry in the field of private security, in the one of the newest state in the world: The Republic of Kosovo. Simultaneously, the work that I have chosen for research is a study of previously untreated or treated too little and researched in Albanian literature, although spoken in passing to the private security industry, they have not been systematically studied yet. In addition, this paper provides an analytical contribution to the privatization of security and the difference between private security companies, military contracting companies and mercenaries.

The study is based on a wide range of printed and electronic literature, including academic literature, research, reports and documents from various non-governmental organizations.

Keywords: Republic of Kosovo, security system, private security companies

1. Hyrje

Kosova, si shumë vende të ndryshme të Evropës Juglindore, mbështetet fuqishëm në kompanitë private të sigurimit për të mbrojtur njerëzit dhe pronën.

Megjithatë, derisa industria private e sigurisë ka luajtur një rol të rëndësishëm në stabilizimin e vendit, ajo ka funksionuar gjatë pa mbikëqyrjen efektive të qeverisë, e sidomos në pjesën veriore të vendit.

Ky punim analizon gjendjen aktuale të industrisë së sigurisë private në Kosovë, dhe kuadrit ligjor me të cilin ajo operon. Njëkohësisht bën edhe trajtimin sistematik të komunitetit të sigurisë në Kosovë që nga viti 1999, shpjegon ngjashmëritë ndërmjet sistemit publik dhe privat të sigurisë, krimeve në vend, shpjegimin dhe dallimin ndërmjet sigurisë private, ushtarake dhe mercenarëve, si dhe bënë rekomandime për përmirësimin e sektorit të sigurisë private.

Roli që industria private e sigurisë mund të luajë në parandalimin e krimit, sigurisht se është i rëndësishëm. Duke konsideruar burimet e industrisë private, në rrugët e qyteteve të Kosovë ka rreth tri herë më shumë punonjës të sigurimit sesa oficer të policisë, dhe rreth dy herë më shumë automjete të patrullave të kompanive private të sigurisë, sesa të policisë.

Ngjashmëritë nuk mbarojnë këtu. Punonjësit e kompanive private të sigurisë gjithashtu veshin uniforma dhe ngasin makina patrulluese, ngjashëm me ato të zbatimit të ligjit. Për më tepër, disa nga funksionet siç janë sigurimi i lokaleve dhe objekteve, patrullat, përgjigjet ndaj thirrjeve të alarmit dhe menaxhimi i turmave, janë të ngjashme për të dy format e policimit. Për më tepër, policimi privat përfshinë më shumë se vetëm patrullimin dhe detyrën e rojës. Shumë nga aktivitetet aleate të këtyre dy funksioneve përfshijnë mbrojtjen e pasurisë dhe mbrojtjen e njerëzve, duke përfshirë shërbimet e mbrojtjes së afërt, shërbimet e transportit të parave të gatshme (TPG), si dhe janë të përfshirë në aspekte të ndryshme që kanë të bëjnë me sigurimin dhe instalimin e pajisjeve të monitorimit dhe pajisjeve të sigurisë. Janë të gjitha këto që do të trajtohen në vijim.

2. Komuniteti i Sigurisë në Kosovë

Menjëherë pas luftës së fundit në Kosovë, në vitin 1999, autoriteti kryesor i sigurimit të brendshëm ishte UNMIK-u (United Nations Mission in Kosovo) dhe KFOR-i (Kosovo Forces). Rezoluta 1244 e Shteteve të Bashkuara, miratuar nga Këshilli i Sigurimit në mbledhjen e vet të 4011-të, më 10 qershor 1999, në paragrafin 15 kërkonte që Ushtria Çlirimtare e Kosovës t'i përmbushin kërkesat për demobilizim, ashtu siç është paraparë nga kryesuesi i pranisë ndërkombëtare të sigurisë në konsultim me Përfaqësuesin Special të

Sekretarit të Përgjithshëm³. Pas demilitarizimit të UCK-së, u krijuan edhe Trupat Mbrojtëse të Kosovës më 19 shtator të vitit 1999⁴. TMK-ja është formuar nga UNMIK-u me Rregulloren 8/1999 dhe nën autoritetin e Përfaqësuesit Special të OKB-së, me detyra dhe mision krejtësisht civil e ndërtuar në bazë të modelit francez të *Security Civile*⁵. Ndërsa, më 6 shtator të vitit 1999, Misioni i OSBE-së në Kosovë, në pajtim me Rezolutën e Kombeve të Bashkuara 1244, ka hapur Shkollën e Policisë dhe ka filluar trajnimin e kandidatëve për pjesëtarë të Policisë së Kosovës⁶.

Rezoluta e Këshillit të Sigurimit 1244/1999, e cila krijoi UNMIK-un, autorizoi Sekretarin e Përgjithshëm, që me ndihmën e organizatave përkatëse ndërkombëtare të vendos një prani civile ndërkombëtare në Kosovë, në mënyrë që të sigurojë një administratë të përkohshme për Kosovën, nën të cilën, populli i Kosovës të mund të gëzojë një autonomi substanciale brenda ish-Republikës Federale të Jugosllavisë, dhe të sigurojë administrimin kalimtar derisa themelon dhe mbikëqyr zhvillimin e institucioneve të përkohshme demokratike vetëqeverisëse, për të siguruar kushte për një jetë paqësore dhe normale për të gjithë banorët e Kosovës⁷. Disa nga përgjegjësitë kryesore të UNMIK-ut ishte edhe ruajtja e rendit dhe ligjit, përfshirë këtu edhe themelimin e forcave policore lokale dhe ndërkohë përmes vendosjes së personelit policor ndërkombëtar për të shërbyer në Kosovë; Ofrimi i sigurisë dhe rendit publik, derisa prania ndërkombëtare civile të mund të marr përgjegjësinë për këtë detyrë; Sigurojë mbrojtjen dhe lirinë e lëvizjes për vete, pranisë civile ndërkombëtare dhe organizatave tjera ndërkombëtare⁸; si dhe shumë detyra dhe përgjegjësi tjera. Ndërsa NATO ka drejtuar një operacion të mbështetjes së paqes në Kosovë – mision ky i quajtur Kosovo Forces (KFOR), që nga qershori i vitit 1999. KFOR-i u krijua kur përfundoi fushata ajrore 78-ditore e NATO-s kundër regjimit të Millosheviqit, që synonte dhënies fund të dhunës në Kosovë. Detyrat kryesore të KFOR-it ishin pengimi i ripërtëritjes së armiqësive, krijimi i një ambienti të sigurt, të ofroj siguri dhe rend publik, çmilitarizoj UCK-në dhe të mbështesë përpjekjet humanitare ndërkombëtare në koordinim me praninë ndërkombëtare civile⁹. Edhe sot, 15 vjet pas përfundimit të luftës në Kosovë, trupat e KFOR-it vazhdojnë të jenë prezente, por në një numër më të vogël. KFOR-i akoma vazhdon të kontribuojë drejt ruajtjes së një mjedisi të sigurt në Kosovë dhe të ofroj liri të lëvizjes për të gjithë¹⁰.

Me themelimin e saj, Policia e Kosovës fillimisht u emërua si Shërbimi Policor i Kosovës. Sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/54, e datës 20 dhjetor 2005, SHPK ishte përgjegjëse për: mbrojtjen e jetës së qytetarëve, sigurisë dhe e pasurisë së tyre personale; mbrojtjen dhe përkrahjen e të drejtave të njeriut; ruajtjen e sigurisë dhe e rendit publik; kapjen e kryerësve të veprave penale dhe kundërvajtjeve; parandalimin, zbulimin dhe hetimin e veprave penale dhe kundërvajtjeve; mbikëqyrja dhe drejtimi i trafikut në rrugët publike dhe në rrugët e paklasifikuara, që aktualisht përdoren për trafikun publik; mbrojtjen dhe kontrollimin e kufijve shtetërorë dhe atyre administrativë në bashkëpunim me Shërbimin Doganor të UNMIK-ut dhe me agjencitë tjera kufitare në pajtim me standardet përkatëse ndërkombëtare dhe evropiane; mbrojtjen e të mirave dhe infrastrukturës publike; ofrimin e ndihmës dhe të qenit në shërbim të popullit pa diskriminim; dhe, kryerjen e detyrave të tjera,

³ Rezoluta e Këshillit të Kombeve të Bashkuara S/RES/1244 (1999), f. 5.

⁴ Sot, 15 vjet nga themelimi i TMK-së, Kosova ende pa ushtri. (2014, Nëntor 19). *Telegrafi* [Prishtinë]. Marrë nga <http://www.telegrafi.com/lajme/sot-15-vjet-nga-themelimi-i-tmk-se-kosova-ende-pa-ushtri-2-50998.html>.

⁵ Qehaja, R., & Kosumi, K. (p.d). *Procesi i demobilizimit dhe integritetit të ish pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare – perspektiva e Kosovës*. Marrë nga faqja zyrtare e QKSS.

⁶ Policia e Kosovës. (p.d). Marrë nga [://www.kosovopolic.com/?page=1,2](http://www.kosovopolic.com/?page=1,2).

⁷ Paragrafi 10 i S/RES/1244 (1999) 10 Qershor 1999.

⁸ UNMIK Mandate – United Nations Interim Administration Mission in Kosovo. (p.d.). Marrë nga <http://www.un.org/en/peacekeeping/missions/unmik/mandate.shtml>.

⁹ NATO's role in Kosovo. (2015, Mars 24). Marrë nga www.nato.int/cps/en/natolive/topics_48818.htm.

¹⁰ Po aty.

të cilat me ligj i ishin caktuar Shërbimit Policor të Kosovës¹¹. Ndërsa pas shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës, më 17 shkurt të vitit 2008, Shërbimi Policor i Kosovës u emërtua si Policia e Kosovës dhe mori kompetencat e plota policore të një policie në shoqëri demokratike. Sipas Ligjit për Policinë e Kosovës Nr. 04/L-076¹², Policia e Kosovës është shërbim publik në kuadër të fushëveprimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), dhe detyrat e përgjithshme të sajë janë: mbrojtja e jetës, pronës dhe të ofrimi i sigurisë për të gjithë personat; mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të të gjithë personave; parandalimi i rrezikut ndaj qytetarëve dhe mbajtja e rendit dhe sigurisë publike; parandalimi dhe zbulimi i veprave penale dhe kryesve të tyre; hetoj i veprave penale dhe kryerësve e tyre; mbikëqyrja dhe kontrolli i sigurisë në komunikacion; menaxhimi dhe kontrolli i kufirit shtetëror; ofrimi i ndihmës gjatë fatkeqësive natyrore dhe në raste të tjera emergjente; dhe kryerja e detyrave tjera të parapara me ligjin në fuqi.

Demilitarizimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës pasoi me krijimin e Trupave Mbrojtëse të Kosovës, ku sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/8¹³, ajo është themeluar si agjenci civile e shërbimit emergjent, ani pse bartte uniformë ushtarake. Sipas po të njëjtës rregullore, detyrë e TMK-së ishte sigurimi i shërbimeve në raste të fatkeqësive natyrore; kërkimi dhe shpëtimi i të rrezikuarve; sipas mundësive të veta të ofroj ndihma humanitare në vendet e izoluara; të ndihmojë në çminimin e zonave të minuara; dhe të kontribuojë në rindërtimin e infrastrukturës dhe të komuniteteve. Ndërkaq, pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, një vit më vonë, në janar të vitit 2009, Trupat e Mbrojtjes së Kosovës u shndërruan në Forcën e Sigurisë së Kosovës, e cila vazhdon të jetë aktive edhe sot, në kuadër të fushëveprimit të Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës. Sipas Ligjit Nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës¹⁴, misioni i FSK-së, si instrument i sigurisë, është që ta mbështesë Qeverinë e Republikës së Kosovës. Detyrat fillestare të Forcës së Sigurisë së Kosovës, janë: të marrë pjesë në operacionet për reagim ndaj krizave, përfshirë operacionet në mbështetje të paqes; të ndihmojë autoritetet civile në përgjigje ndaj fatkeqësive natyrore, fatkeqësive dhe emergjencave tjera, madje edhe si pjesë e një përpjekjeje reaguese regjionale apo ndërkombëtare; të kryejë shkatërrimin e mjeteve shpërthyes; dhe, të ndihmojë autoritetet civile përmes operacioneve të mbrojtjes civile. Në një të ardhme shumë të afërt, pritet që Forca e Sigurisë së Kosovës të transformohet në Forcat e Armatosura të Kosovës, me të gjitha të drejtat ligjore që dalin nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Projektligji për themelimin e FAK-ut është gati dhe pritet sigurimi i 2/3 të votave të deputetëve dhe ndryshimet kushtetuese¹⁵. Sipas projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë Forcat e Armatosura të Kosovës¹⁶, FAK do të jenë forca kombëtare ushtarake të Republikës së Kosovës, dhe mund të dërgojnë pjesëtarët e saj jashtë vendit, në përputhje të plotë me përgjegjësitë e saj ndërkombëtare. Detyrat e Forcave të Armatosura të Kosovës do të jenë: të mbrojnë sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës së Kosovës; të marrin pjesë në operacionet mbështetëse për reagim ndaj krizave dhe në mbështetje të paqes; ndihmojë popullsinë dhe autoritetet civile në përgjigje ndaj fatkeqësive natyrore dhe emergjencave tjera; dhe, të kryej shkatërrimin e mjeteve shpërthyes.

Numri i të punësuarve në polici dhe forcat e sigurisë lokale në Kosovë, duke mos përfshirë KFOR-in, është vlerësuar diku rreth 11046, ndërsa me kalimin e Forcës së Sigurisë

¹¹ UNMIK/RREG/2005/54. (2005, Dhjetor 20). *Rregullore nr. 2005/54 mbi kornizën dhe parimet drejtuese të Shërbimit Policor të Kosovës.*

¹² Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2012). *Ligji Nr.04/L-076 për Policinë.*

¹³ UNMIK. (1999, Shtator 20). *Rregullore Nr. 1999/8 Për Themelimin e Trupave Mbrojtëse të Kosovës.*

¹⁴ Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2008). *Ligji Nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës.*

¹⁵ Gazeta Express. (2015, Prill 01). *Ligji për FAK-un pret 2/3 e votave, në veri vetëm me leje të NATO-s.*

¹⁶ Kuvendi i Republikës së Kosovës. (p.d.). *Projektligji Nr. 04/L-275 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë Forcat e Armatosura të Kosovës.*

së Kosovës në Forcat e Armatosura të Kosovës, ky numër do të rritet, por jo edhe në përqindje të madhe.

Në kuptimin e numrit të përgjithshëm, Policia e Kosovës përfaqëson një nga organizatat policore më të vogla në Ballkanin Perëndimor dhe Evropë në përgjithësi. Në fillim të vitit 2009, PK kishte gjithsej 7076 policë në shërbim të popullsisë së vlerësuar në 2.2 milionë banorë. Kjo do të thotë që ka 321 policë në 100.000 banorë, duke e vendosur atë fuqimisht në kufirin e ultë të raportit polic/banorë në rajon, prapa Kroacisë (449) dhe Maqedonisë (488)¹⁷. Ndërsa deri në vitin 2012, Policia e Kosovës kishte të punësuar 8546 policë, me një buxhet vjetor prej rreth 79 milion euro¹⁸. Në anën tjetër, bazuar në misionin e saj, Forca e Sigurisë së Kosovës ka një forcë prej 2500 pjesëtarë të rregullt dhe 800 rezervë, të cilët janë të trajnuar dhe të pajisur mirë dhe të gatshëm për të marrë përgjegjësi të reja¹⁹. Ndërkaq, pas transformimit në Forcat e Armatosura të Kosovës, ky numër pritet të rritet nga një komponentë aktive prej më së shumti 5000 pjesëtarë dhe nga një komponentë rezervë prej më së shumti 3000 pjesëtarë²⁰. Megjithëse, konsiderojmë se në lidhje me rolin e shërbimeve private të sigurisë, ia vlen që të angazhohen agjencitë private të sigurimit në ruajtjen e objekteve ushtarake, duke zëvendësuar ushtarët në pozita të tilla, për arsye se aktivitetet që nuk kanë të bëjnë me trajnimin dhe edukimin, janë një humbje kohe për ushtarët. Kjo veçanërisht është e vërtetë kur bëhet fjalë për ruajtjen e objekteve ushtarake. Mendim të njëjtë kemi edhe për zyrtarët e Policisë së Kosovës, të cilët janë të angazhuar në sigurimin e objekteve.

Ndërsa, ajo që është e përbashkët e Kompanive Private të Sigurisë në Kosovë, Policisë së Kosovës dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës, është shërbimi i mbrojtjes së afërt. Në kuadër të Divizionit të Njësive të Specializuara të Policisë së Kosovës, operon Njësia e Mbrojtjes së Afërt (NJMA) e cila, deri më tash ka pasur rolin e sigurimit të personaliteteve me rendësi të veçantë, përcjelljen e delegacioneve të ndryshme, përcjelljen dhe ekstradimin e të dyshuarve, mbrojtjen e personaliteteve të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, kontrollimet antiterroriste, arrestimin e personave me rrezikshmëri të lartë dhe gjithashtu sigurimin e objekteve diplomatike dhe qeveritare. Edhe më tutje ajo do të përkujdeset për personalitetet me rendësi të veçantë²¹. Nga ana tjetër, në kuadër të Policisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës, operon Togu i Mbrojtjes së Afërt (TMA), i cili, duke u bazuar në Rregulloren Nr. 04/2010 për Policinë e FSK-së²², siguron mbrojtje të afërt për vizitat e personave të rëndësishëm dhe siguron mbrojtje të konvojëve dhe eskortave të sigurisë së veturave të cilat transportojnë armë, municion, karburant dhe eksplozivë.

Gjithashtu, reagimi policor tradicional ka të bëjë kryesisht me përgjigjen e thirrjeve dhe kryerjen e hetimeve pasuese. Në mënyrë të ngjashme, kompanitë e sigurimit rregullisht reagojnë për krimin që është duke zhvilluar apo që tashmë ka ndodhur. Për shembull, një punonjës mund të shtyp butonin e panikut kur zhvillohet një grabitje me armë zjarri në një biznes, apo pronari i një shtëpie mund të telefonoi kompaninë e tij kur ai sheh dikë duke thyer garazhin e tij. Që të dy, personeli i policisë dhe ai i sigurimit, pothuajse në të njëjtën kohë kryejnë detyra të cilat disa mund ti argumentojnë si proaktive. Për shembull, patrullat rutinore

¹⁷ EULEX Kosovo. (2009, Korrik). *Raporti për Programet* (01), f. 96.

¹⁸ Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ) dhe Instituti për Studime të Avancuara GAP. (2012, Mars). *Buxheti i Policisë së Kosovës - nevojat për buxhet shtesë dhe planifikim më të mirë financiar*, f. 3.

¹⁹ Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës. (2010). Ngritja, sfidat dhe sukseset e FSK së. *Zyra për Marrëdhënie me Publikun*, f. 5.

²⁰ Kuvendi i Republikës së Kosovës. (p.d.). *Projektligji Nr. 04/L-275 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me Forcat e Armatosura të Kosovës*.

²¹ Riorganizohen Njësitet Elite. (2012, Janar 02). *Gazeta Jeta në Kosovë* [Prishtinë]. Marrë nga <http://gazetajnk.com/?cid=1,1040,995>.

²² Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës. (2010, Prill 16). *Rregullore Nr. 04/2010 për Policinë e FSK-së*, f. 5.

të policisë përfshinë ngasjen e makinës përreth lagjeve të ndryshme të qytetit, me shpresën se krimi do të ketë më pakë gjasa të ndodhë, për shkak të pranisë fizike të oficerëve të zbatimit të ligjit. Në mënyrë të ngjashme, një roje i cili është i punësuar për të patrulluar përreth lokaleve afariste mund të parandaloj krimin duke qenë i pranishëm dhe duke vëzhguar.

Për të kuptuar mënyrën se si organet e cekura më lartë funksionojnë, këto duhet të maten me nivelet dhe llojet e krimeve në Kosovë.

3. Krimet në Kosovë

Krimi është një veprim ose mos veprim që përbën një vepër penale, e cila mund të ndiqet nga shteti dhe e cila është e dënueshme me ligj. Sot, krimi është një fakt i spikatur, një pjesë integrale e rreziqeve me të cilat përballemi në jetën e përditshme. Krimi në opinionin shkencor dhe publik është i lidhur me lëndimet dhe dhunën; dëmet ndaj individëve; shkatërrimit të pronës; dhe mohimi i respektit ndaj njerëzve dhe institucioneve.

Kosova mbetet shumë prapa vendeve tjera të Evropës Juglindore në sundimin e ligjit. Keqeverisja serbe dhe shtypja në vitet 1990, menaxhimi i keq por dashamirës i administratës së OKB-së deri në vitin 2008, varfëria e thellë, dyshimin e ngulitur në institucione dhe procedurat formale me një udhëheqje me shumë pak përvojë në qeverisje, të gjitha kanë luajtur rol²³.

Problemet me të cilat përballen qytetarët e Kosovës, janë kryesisht të lidhura me çështjet ekonomike. Rasti i papunësisë është edhe më i qartë. Rreth 45% e popullsisë në Kosovë jeton nën kufirin e varfërisë, dhe gati gjysma e popullsisë e cila është e aftë për punë është e papunë²⁴.

Në Raportin e Progresit për Kosovën, për vitin 2014, ndër të tjera thuhet se sundimi i ligjit, duke përfshirë pavarësinë e gjyqësorit, si dhe rezultatet e ulëta në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, mbetet një shqetësim i madh. Tutje në këtë raport thuhet se, në lidhje me luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, numri i hetimeve të krimit, të lidhura me drogën janë rritur dhe disa grupe të trafikut njerëzor janë ulur²⁵. Kosova është në një fazë të hershme për të dhënë rezultate në luftë kundër krimit të organizuar, e cila vazhdon të jetë një sfidë serioze. Numri i përgjithshëm i aktakuzave dhe aktgjykimeve në rastet e trafikimit të narkotikëve dhe trafikimit me qenie njerëzore, mbetet i ulët. Agjencitë e zbatimit të ligjit kanë qenë të gatshme për të filluar hetime financiare. Si rezultat, numri i konfiskimeve dhe sekuestrimeve urdhëruar nga gjyqësori dhe të ekzekutuara nga policia vazhdon të jetë e ulët. Ka një mungesë të ekspertizës në mesin e prokurorëve dhe gjyqtarëve në fushat e specializuara të tilla si krimi financiar dhe mashtrimi i prokurimit. Kjo ekspertizë është esenciale për t'u marrë me korrupsionin. Zbatimi i strategjisë anti-korrupsion dhe plani i veprimit, nuk ka arritur të gjenerojë rezultate efektive, për shkak të mbështetjes së dobët politike. Raporti vjetor tregon që për periudhën qershor-dhjetor 2013, Agjencia Kundër Korrupsion (AKK), konsiderohet se vetëm 54% e veprimeve ishin duke u implementuar ose janë impementuar pjesërisht²⁶.

Sipas Raportit për Programet i EULEX-it, publikuar në korrik të vitit 2009, ndër të tjera thuhet se, nivelet e krimeve në Kosovë dhe performanca e Policisë së Kosovës (PK) lidhur me hetimin e krimeve të shikohen brenda një konteksti më të gjerë të Evropës. Numri i krimeve të evidentuara në vitin 2006 në Kosovë ishte nën 3,000 për 100,000 banorë, që është dukshëm më i ulët sesa mesatarja e mostrës nga një grup i përbërë prej njëmbëdhjetë shteteve

²³ Crisis Group Europe Report Nr. 204. (2010, Maj 19). *The Rule of Law in Independent Kosovo* f. 5.

²⁴ Briscoe, A., & Price, M., (2011). "Kosovo's new map of power: governance and crime in the wake of independence". Netherlands Institute of International Relations, The Hague, f. 12.

²⁵ European Commission. (2014). *Kosovo Progress Report*, f. 1-2.

²⁶ Po aty, f. 15-22.

anëtare të BE-së. Megjithatë, brenda kontekstit të ish-Jugosllavisë, niveli i krimeve të evidentuara në Kosovë duket të jetë relativisht i lartë. Po kështu, është me rëndësi të ceket se, numri i veprave penale në Kosovë është përafërsisht tri herë më i lartë sesa niveli i tyre në territorin fqinjë të Maqedonisë, shtet ky me një numër të përafërt të popullsisë dhe me përbërje të ngjashme urbane dhe rurale²⁷.

Rastet me të cilat përballen më së shumti kompanitë private të sigurisë, janë krimet e vjedhjes. Duke bërë një krahasim më mes të tremujorit të parë të vitit 2014 dhe tremujorit të parë të këtij viti, rezulton se ka një rënie të theksuar të rasteve të vjedhjeve. Pra vetëm në tre mujorin e parë të vitit 2014 kemi 2,133 raste të vjedhjeve, prej tyre 193 janë tentim vjedhje, ndërsa vjedhje të kryera janë 1,940. Ndërsa në tre mujorin e parë të këtij viti, kemi në total 1,510 raste të vjedhjeve. Prej tyre 146 janë tentim vjedhje ndërsa vjedhje të kryera janë 1,364²⁸.

Nivelet e raportimit të krimeve janë të dokumentuara mirë. Shkalla e raportimit të veprave nga ana e viktimave (apo nga palët të treta) në polici është shumë e ndërlydhur me llojin e veprës. Për shembull, në shumë shtete të BE-së raportohen pothuajse të gjitha vjedhjet e veturave apo motoçikletave, si dhe shumica e plaçkitjeve të shtëpive/banesave; rreth dy të tretat e vjedhjeve nga veturat dhe pothuajse më shumë se gjysma e rasteve të vjedhjeve të biçikletave dhe plaçkitjeve; vetëm rreth një e treta e të gjitha sulmeve dhe kërcënimeve raportohen në polici, ndonëse shifra është më e lartë për sulmet me dhunë (45%) sesa për kërcënimet (29%); incidentet seksuale janë rastet që raportohen më së rralli (një mesatare prej 15%). Niveli i krimeve të evidentuara në Kosovë (për vitin 2006 është 64 165) paraqet një sfidë dukshëm më të madhe për pjesëtarët e Policisë së Kosovës sesa për kolegët e tyre në Maqedoni dhe Kroaci. Çdo polic i Kosovës është përgjegjës për të trajtuar pothuajse 9 krime në vit, krahasuar me 4 në Kroaci dhe vetëm 2.2 krime që trajtohen nga një polic në Maqedoni. Ndonëse vëllimi i punës së PK-së është vetëm sa gjysma e mesatares në mostrën e grupit të shteteve anëtare të BE-së, megjithatë kjo është një sfidë domethënëse për policinë më të re në Evropë²⁹.

Tani që një kontekstualizim i përgjithshëm i sigurisë dhe kriminalitetit është paraqitur, kjo punë kthehet në argumentet e saj kryesore që ekspozojnë lidhjen në mes të biznesit privat dhe sigurisë private në Kosovë.

4. Kuadri Aktual i Industrisë së Sigurisë Private

Siguria private, në mënyrën më të thjeshtë, do të mund të shpjegohej si autorizim i deleguar në sferën e sigurisë, e cila përbën domenin ekskluziv dhe monopolin e strukturave politike të një shteti gjegjësisht një bashkësia shtetërore si të tillë në duart e një individi ose të disa individëve, në pajtim me zgjidhjet dhe autorizimet që ia jep shteti. Kështu sigurinë private mund të definojmë³⁰:

Si sistem specifik dhe dinamik të kontrollit shoqëror, i cili, me qëllim të ofrimit të shkallës më të lartë të sigurisë individuale të qytetarëve por edhe të interesave ekonomike të tyre i ndërmerr aparati i një bashkësia shoqërore e politike, në mënyrë që të hiqet dorë nga monopoli në sektorin e sigurisë publike kështu që në mënyrë komerciale, si veprimtari ekonomike, u lejohet individëve, agjencive dhe kompanive, duke kufizuar njëkohësisht fushën e veprimit të tyre në sektorin e sigurisë, duke

²⁷ EULEX Kosovo. (2009, Korrik). *Raporti për Programet (01)*, f. 26.

²⁸ Të gjithë të atakuar nga hajnat. (2015, Prill 26). *Portali Telegrafi*. Marrë nga <http://www.telegrafi.com/lajme/te-gjithe-te-atakuar-nga-hajnat-80-9571.html>.

²⁹ Po aty, f. 26-28.

³⁰ Ahić, J., (2008). *“Sistemet e Sigurisë Private”*. Sarajevë-Prishtinë, f. 7.

nxjerrë akte ligjore dhe nënligjore, si dhe duhet caktuar kodin e sjelljes etike e profesionale të punëtorëve në sektorin e sigurisë private.

Në këtë kontekst të këtij definicioni, mund të japim edhe një definicion pune për vetë sistemin e sigurisë private³¹:

Sistemi i sigurisë private të një shteti përbën tërësinë e veprimeve dhe raporteve të individëve, agjencive dhe kompanive të cilave shteti ua lejon të komercializojnë në pjesë të sektorit të sigurisë, i cili përfshin që të pesë nivelet e konceptit të sigurisë private por edhe të shtetit që, nëpërmjet dispozita ligjore, i vë nën kontroll dhe mbikëqyrje personat dhe institucionet që janë të përfshirë në aktivitete të mbrojtjes së sigurisë, si dhe përcakton parimet etike dhe standardet profesionale që janë të obligueshme për të gjitha ata që janë përfshirë në këtë sistem.

Në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-004 për Shërbimet Private të Sigurisë, rregullon të gjitha aktivitetet në fushën e sigurisë private. Bazuar në këtë ligj, shërbimet e sigurimit ofrohen vetëm nga kompanitë private të sigurimit, të licencuara dhe të autorizuar në pajtim me ligjin. Këto shërbime ushtrohen vetëm përmes punëtorëve të licencuar të sigurimit. Shërbimet e sigurimit në Kosovë, mund të ofrohen në këto fusha³²:

1. shërbimet themelore të sigurimit;
2. shërbimet e mbrojtjes së afërt;
3. shërbimet e TPG-së (Transportit të Parave të Gatshme);
4. shërbimet e vëzhgimit elektronik të pronës; dhe
5. shërbimet e sigurimit të tubimeve publike.

Institucioni përgjegjës për krijimin e kuadrit rregullator, përcaktimit të rregullave dhe kushteve për industrinë e sigurisë private në Kosovë, është Ministria e Punëve të Brendshme, Departamenti i Sigurisë Publike, Divizioni për Kompanitë Private të Sigurisë.

Sipas Ligjit Nr. 04/L-004, Neni 7, Divizioni kryen funksione lidhur me licencimin dhe autorizimet e përcaktuara me ligj; shërben si pikë kontakti për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me shërbimet private të sigurisë; kryen monitorimin e aktiviteteve të kompanive private të sigurimit; kryen inspektime për monitorimin dhe rishikimin e aktiviteteve të kompanive private të sigurimit; vendosë dhe aprovon standarde profesionale; bën rekomandime dhe propozime për ruajtjen dhe përmirësimin e këtyre standardeve; lëshon, plotëson, zgjasë, suspendon dhe revokon licencat; shqipton dënime me gjobë në pajtim me ligjin; udhëheq procesin e regjistrimit dhe evidentimit të kompanive private të sigurisë; respekton procedurat për mbrojtjen e të dhënave personale dhe qasjen në informata publike; lëshon kartela të identifikimit për punëtorët e sigurimit; organizon provimin për certifikim dhe ricertifikim të punëtorëve të sigurimit; dhe siguron kryerjen e vlerësimit të kërcënimit për personat që sigurohen³³. Udhëheqësi i Divizionit për Shërbimet Private të Sigurisë, raporton tek Udhëheqësi i Departamentit për Siguri Publike, ndërsa numri i të punësuarve në këtë divizion është pesë (5)³⁴.

³¹ Po aty.

³² Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2011, Qershor 23). *Ligji Nr. 04/L-004 për Shërbimet Private të Sigurisë*. f. 1-6.

³³ Po aty, f. 6-7.

³⁴ Qeveria e Republikës së Kosovës. (2013, Dhjetor 19). *Rregullore (QRK) Nr. 36/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Ministrisë së Punëve të Brendshme*, f. 13.

Megjithatë, vetëm për shkak se një entitet i veçantë është i interesuar të hyjë në tregun privat të sigurisë dhe ka kapital për ta bërë këtë, nuk i jep të drejtë atij që në mënyrë të thjeshtë ta bëjë. Në vend të kësaj, ka një seri kërkesash të çdo sektori të biznesit, që ndryshojnë në lidhje me licencimin e një organi individual apo të korporatës. Për shembull, organet e korporatës së pari duhet të regjistrojnë biznesin e tyre në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë, pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, e më pas aplikantët duhet të plotësojnë kushtet e përcaktuara me ligjin Nr. 04/L-004 dhe të kalojnë verifikimin e së kaluarës para se t'u jepet licenca për të ofruar shërbimet e sigurimit. Kjo nënkupton që aplikantët duhet të aplikojnë për licencë për secilin shërbim të sigurimit të përcaktuar nga ky ligj. Në të kundërtën, për të gjithë personat fizik që dëshirojnë të hynë në tregun e kompanive private të sigurisë, në pajtim me Nenin 16 të Ligjit Nr. 04/L-004, duhet t'i plotësojnë këto kushte: të ketë aftësi fizike dhe mendore të kryejë detyrat e veta; të ketë arritur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare; të ketë zotësi të plotë juridike për të vepruar; të ketë të përfunduar me sukses trajnimin themelor profesional dhe posedon certifikatën të cilën e dëshmon; të ketë kaluar me sukses provimin e organizuar nga organi kompetent; dhe të ketë kaluar me sukses verifikimin e së kaluarës.

Siguria private në Kosovë është duke u zhvilluar çdo ditë e më shumë. Saktësia dhe besueshmëria e fakteve dhe konstatimeve nga çdo iniciativë hulamtuese është e kufizuar për shkak të zhvillimeve dinamike dhe joformaliteteve potenciale në këtë sektor. Në janar të vitit 2009, të dhënat zyrtare tregonin se në Kosovë ekzistonin 48 Kompani Private të Sigurisë (KPS) vendore dhe ndërkombëtare, nga të cilat 44 janë kosovare dhe 4 të tjera ndërkombëtare. Më shumë se gjysma e KPS-ve janë me bazë në Prishtinë, një prani e konsiderueshme e KPS-ve janë të regjistruara në rajonin e Prizrenit, Gjilanit dhe Ferizajt. Pothuaj të gjitha KPS-të janë në pronësi të shqiptarëve të Kosovës, me përjashtim të njëres që gjendet në pjesën veriore të Kosovës dhe që është pronë e një serbi të Kosovës. Përveç kësaj, disa KPS, kryesisht ato në veri të Kosovës, ushtrojnë aktivitetin e tyre jashtë kornizës ligjore³⁵.

Sipas një hulumtimi për Kompanitë Private të Sigurisë në Kosovë, publikuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë³⁶, në Kosovë janë 3750 roje të regjistruar të sigurisë. Megjithatë, as personat përgjegjës nuk e mohojnë faktin se ky numër është më i madh. Në bazë të informatave të marra nga KPS-të, nga shënimet zyrtare dhe po ashtu duke llogaritur praktikantët e mundshme (që duhet të sqarohen në pjesët e tjera përkatëse) në vlerësojmë se mund të ketë rreth 4000-4500 individë të punësuar nga KPS-të. Është pothuaj e pamundur të gjendet numri i saktë i personave të punësuar për një varg arsyesh.

Duke marrë parasysh përdorimin e armëve të zjarrit, punonjësit privat të sigurisë janë të lejuar për të bartur armë të zjarrit (megjithëse jo armë automatike), dhe në praktikë, kjo nuk është shumë e zakonshme që ata të jenë të armatosur. Ligji Nr. 04/L-004³⁷ në Nenin 30, thekson se vetëm operatorët e mbrojtjes së afërt dhe rojet e TPG-së, mund të jenë të pajisur me armë. Operatorët e mbrojtjes së afërt dhe rojet e TPG-së, të licencuar mund të armatosen vetëm me armë të autorizuara dhe bartin vetëm kur janë në detyrë. Ata mund të përdorin armën vetëm si zgjidhje e fundit, kur mjetet e tjera janë të pamjaftueshme për të mbrojtur veten ose të tjerët nga sulmi i pashmangshëm për jetë. Dhe, nëse nga këta operatorë është shtënë me armë zjarri, ata janë të obliguar që menjëherë ta njoftojnë Policinë e Kosovës dhe nuk duhet të largohet nga detyra derisa të jepet leja për këtë nga policia.

³⁵ Qehaja, F., Vrajolli, M., & Perteshi, S. (2009), "Kompanitë Private të Sigurisë në Kosovë". Qendra Kosova për Studime të Sigurisë (QKSS), Prishtinë, f. 12.

³⁶ Po aty.

³⁷ Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2011, Qershor 23). *Ligji Nr. 04/L-004 për Shërbimet Private të Sigurisë*. f. 21-22.

Përdorimi taktik i qenve në shumë vende të Evropës është i ndaluar rreptësisht, ndërsa në Kosovë përdorimi i qenve të sigurimit lejohet vetëm për aktivitetet e shërbimit të sigurimit themelor, ku secili qen duhet të ketë të instaluar një mikroçip për qëllime të identifikimit, dhe qentë e sigurimit duhet të trajnohen dhe licencohen në pajtim me standardet profesionale të Kosovës (Neni 31 i Ligjit Nr. 04/L-004).

Ndërsa një fenomen i përhapur në Kosovë është përfshirja e kompanive private të sigurimit në ofrimin e shërbimeve për autoritetet e sektorit publik (duke përfshirë ruajtjen e organeve qendrore të administratës publike, ambasadave dhe objekteve tjera me rëndësi). Kritikët e kësaj gjendje thonë se agjencive private ju është dhënë kontrata për ruajtjen e objekteve publike pa qenë e nevojshme trajnimi i stafit në një mënyrë të mjaftueshme. Mendim të përfaqshëm të qëndrimit tonë ka edhe hulumtimi i bërë nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë³⁸, e cila thotë se, së pari, disa punëtorë mund të mos jenë deklaruar, duke u munduar të shmangen përgjegjësitë ligjore dhe financiare që përcaktohen në Ligjin për punësim. Kjo vjen si rezultat i mungesës së një mekanizmi të duhur të inspektimit dhe kontrollit, si dhe i mungesës së përgjegjësisë shoqërore të KPS-ve. Së dyti, disa individë punësohen vetëm për shërbime afatshkurtra dhe kjo varet nga paqëndrueshmëria dhe kërkesa e tregut. Në zhargonin lokal ky njihet si “punësim i përcaktuar nga tenderët”. Për ta thjeshtuar, ata punësohen për shërbime afatshkurtra dhe pastaj pezullohen nga puna. Së fundi, veprimtaria e përgjithshme e shumë KPS-ve të paregjistruara, e veçanërisht atyre në pjesën veriore të Kosovës mbështet supozimet tona të mëhershme. Tutje në këtë hulumtim thuhet se, disa kompani të vogla ose prona private e shfrytëzojnë mënyrën e vjetër të sigurisë fizike, siç është punësimi i një “personi të moshuar” ose dikujt tjetër, për të qenë i pranishëm dhe për të “frikësuar” plaçkitësit dhe grabitësit. Ndërsa thuhet se situata është edhe më e qartë në shërbimet e mbrojtjes së afërt, në të cilat VIP-at zakonisht preferojnë të angazhojnë ndonjë anëtarë të familjes së tyre ose ndonjë mik, e jo ndonjë operatorë nga kompanitë private të sigurisë.

Kompanitë e sigurimeve akuzohen se shkelin më së shumti të drejtat e punëtorëve. Por indirekt përgjegjësinë për shkelje e kanë institucionet shtetërore nëpërmjet kushteve të tenderëve për sigurimin fizik të objekteve publike. Kompanitë që aplikojnë nëpër tenderë marrin kontrata të cilat mund të zbatohen vetëm nëse të gjithë punëtorët e angazhuar i ka nën moshën 35vjeçare. Kjo për të mos rënë ndesh me vendimin e qeverisë për caktimin e pagës minimale në Kosovë. Ky vendim thotë se paga minimale për personat që janë nën moshën 35vjeçare është 135 euro, ndërsa mbi këtë moshë është 170 euro. Dhe, natyrshëm, kompanitë përcaktohen për më pak shpenzime e më shumë fitim. Inspektorati i Punës, i cili mbikëqyr zbatimin e Ligjit të punës dhe ligjet tjera që lidhen për vendin e punës tek kompanitë private, e pranon se kompanitë që merren me sigurimin fizik janë shpesh shkelëse të Ligjit të punës³⁹.

Këto shifra ndihmojnë në njohjen e gjendjes së përgjithshme me të cilat përballen shërbimet private të sigurisë në Kosovë, dhe natyrisht këto ofrojnë njohuri për disa nga problemet e ngulitura. Ndërsa për të kuptuar më mirë rolin e kompanive private të sigurisë, ne do të vazhdojmë trajtimin e këtij punimi në dallimin që qëndron ndërmjet kompanive private të sigurisë, kompanive private ushtarake dhe mercenarëve.

5. Dallimi ndërmjet kompanive private të sigurisë, kompanive private ushtarake dhe mercenarëve

³⁸ Qehaja, F., Vrajolli, M., & Perteshi, S. (2009). vepër e cit.. Qendra Kosova për Studime të Sigurisë (QKSS), Prishtinë, f. 12.

³⁹ Paga minimale i bën të vuajnë punëtorët e sigurimit fizik. (2014, Shkurt 18). *Gazeta Bota Sot*. Marrë nga <http://botasot.info/lajme/274333/paga-minimale-i-ben-te-vuajne-punetoret-e-sigurimit-fizik/>.

Sot, trendi global për kontraktimin e furnizimit të shërbimeve ushtarake dhe të sigurisë është vazhdimisht në rritje. Siguria është duke u transformuar nga një shërbim për të mirën publike apo të përbashkët, në një shërbim të ofruar privatisht. Kompanitë e mëdha private të vendeve të ndryshme, kanë zhvilluar dhe avancuar në materiale dhe burime njerëzore, sesa agjencitë e sigurisë dhe ushtritë e shumë vendeve sovra⁴⁰.

Dallimi ndërmjet aktorëve bashkëkohorë të sigurisë private nga pararendësit e tyre mercenarë, në të njëjtën kohë është një detyrë komplekse dhe e drejtpërdrejtë. Aktiviteti mercenar është i paligjshëm me Konventën Ndërkombëtare të vitit 1989 kundër Rekrutimit, Përdorimit, Financimit dhe Trajnimit të Mercenarëve dhe Konventa për Eliminimin e Mercenarizmit në Afrikë nga Organizata e Unitetit Afrikan e vitit 1977 (OUA – tani Bashkimi Afrikan, BA). Megjithatë asnjë nga këto instrumente ligjore ndërkombëtare nuk është i aplikueshëm për aktivitetet e kompanive private të sigurisë. Shumica e kompanive private të sigurisë janë si çdo kompani tjetër private: ato kanë strukturat konvencionale të korporatave, veprojnë si persona juridik, dhe ruajnë faqe të ndryshme interneti dhe lidhje të korporatave. Në vende të ndryshme të botës, shërbimet e ofruara nga kompanitë private të sigurisë dhe ushtarake shkojnë nga sigurimi i mbështetjes operationale në luftime, këshilla ushtarake dhe trajnime, prokurim të armëve dhe mirëmbajtje për mbështetje logjistike, strehim, shërbime të komunikimit, shërbime të sigurisë, mbledhjen e inteligjencës dhe parandalimin e krimit. Përpjekjet për të ndarë dhe kategorizuar aktorët privat në sektorin e shërbimeve të sigurisë më saktësisht, janë debatuar shumë⁴¹.

Kompanitë Private Ushtarake (KPU) janë biznese që ofrojnë shërbime të specializuara në lidhje me luftën dhe konfliktin, duke përfshirë operationet luftarake, planifikimin strategjik, mbledhjen e inteligjencës, mbështetjen operative dhe logjistike, trajnime, prokurim dhe mirëmbajtje⁴². Nocioni më i popullarizuar për “mercenar” është një person, i cili lufton për përfitime financiare në konfliktet e armatosura të huaja, nocion ky që vjen nga historia post-koloniale e Afrikës⁴³. Ndërsa definicionin për kompanitë private të sigurisë e kemi dhënë në pjesën më lartë.

Në mars 2003, u vlerësua se 15.000-20.000 kontraktorë privatë të sigurisë punonin në Irak dhe se konflikti u quajt “lufta e parë e privatizuar”. Që atëherë numri dhe shfaqja e personelit të kontraktuar u rrit, çka nxiti një debat të gjerë mbi rolin e kompanive private që ofrojnë shërbime ushtarake e sigurie për shtetet, korporatat dhe OJQ-të. Megjithatë, fenomeni nuk është as i ri dhe as ekskluziv në konfliktin e Irakut. Në dekadën e kaluar u pa ngritja dhe konsolidimi i një industrie globale për shërbimet private të sigurisë me mbi 100 kompani që veprojnë në po aq vende në mbarë botën. Shërbimet private ushtarake e të sigurisë sfiduan pretendimet konvencionale rreth rolit të shtetit si protagonist kryesor në çështjet ushtarake dhe si garantues i sigurisë fizike të shtetasve të tij. Në mungesë të strukturave efektive ligjore apo rregullatore, këto aktivitete ngritën problemet e ligjshmërisë, legjitimitetit dhe përgjegjësisë në fushën e politikës së sigurisë⁴⁴.

Termet Kompani Private të Sigurisë (KPS) dhe Kompani Private Ushtarake (KPU), janë përdorur në kontekste të ndryshme. Teknikisht dallimi është në mes të shërbimeve që ato ofrojnë. Një Kompani Private Ushtarake ofron shërbime ushtarake luftarake (ofensive dhe defensive), si dhe trajnime ushtarake dhe inteligjencë. Në krahasim me këtë, Kompanitë

⁴⁰ Tzifakis, N., (2012). “Contracting out to Private Military and Security Companies”. Centre for European Studies, f. 6.

⁴¹ Holmqvist, C., (2005). “Private Security Companies: The Case for Regulation”. Stockholm International Peace Research Institute. SRI Policy Paper Nr. 9, f. 3-5.

⁴² Private Military Companies. (2006). DCAF - The Geneva Centre for the Democratic Control of Armed Forces, Nr. 04.

⁴³ Lilly, D., (2000). “The privatization of security and peace building: a framework for action”. International Alert, London, f. 8.

⁴⁴ Çështje të Sigurisë. (2008). *Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim*. Nr. 7, f. 90.

Private të Sigurisë ofrojnë siguri aktuale për interesa komerciale dhe/ose interesa të qeverisë, mbrojtjen e afërt, vlerësimin dhe analizat e rrezikut⁴⁵.

Ne gjithashtu mendojmë se dallimi në mes të Kompanive Private Ushtarake dhe Mercenarëve qëndron në mënyrën e organizimit të tyre, ndërsa qëllimi është i përbashkët – i njëjtë. Kompanitë Private Ushtarake janë më të organizuar dhe operojnë me numër më të madh, ndërsa Mercenarët janë kryesisht individ të cilët operojnë të vetmuar. Sipas ligjeve ndërkombëtare aktivitetet e Mercenarëve janë të paligjshme, ndërsa ato të Kompanive Private Ushtarake nuk janë, ndërsa shumë kritikë mendojnë se dallimi qëndron vetëm në emër. Në kushte të ligjshmërisë, një mercenar nuk ndjek ndonjë rregull ligjore (dhe kjo është arsyeja pse ata janë të punësuar, për të pastruar rrëmujën e njerëzve dhe për të bërë punë të pista), ndërsa KPU-të janë ndryshe, ata gjithashtu janë të përjashtuar nga ligjet e vendit ku operojnë, por nuk përjashtohen nga ligjet ndërkombëtare.

5. Vështrim Kritik i Sigurisë Private në Kosovë

Dobësitë kryesore në sektorin e sigurisë private në Kosovë mund të përshkruhen si kryqëzim i disa faktorëve negativ.

Së pari, një kompani që drejton një biznes pa licencë, siç është rasti i veriut të vendit, nuk vepron në përputhje me rregullat e shëndetit dhe sigurisë në punë, nuk paguan taksa dhe sigurime shoqërore për stafin e saj (etj.), dhe nuk ka gjasa për të kontaktuar Policinë e Kosovës në rast të ndonjë telashe, por më tepër ka gjasa që këtë ta zgjedhin përmes një agjencie private të sigurisë.

Së dyti, ligji kërkon inspektime, por shpesh nuk ka të holla për të kompensuar punën jashtë orarit, si dhe pagat e ulëta të punonjësve të kompanive private janë tejet të ulta, në krahasim me punën që kryejnë dhe me orarin e tyre, madje ndonjëherë të tejzgjatur. Kjo ndër të tjera, hap mundësinë për korrupsion.

Së treti, ligji kërkon gjithashtu që punëtorët e kompanive private të sigurisë të kenë kaluar me sukses verifikimin e së kaluarës, por në realitet kjo bëhet vetëm formalisht, e jo sipas procedurave të verifikimit.

Së katërti, përveç Ministrisë së Punëve të Brendshme, nga ana e qeverisë nuk ka ndonjë mbikëqyrje efikase për këtë sektor të sigurisë.

Së fundi, angazhimi i personave të pa licencuar për shërbime të sigurimit fizik te disa biznese private bëhet në kundërshtim me Ligjin mbi shërbimet private të sigurisë, bëjnë të ditur përfaqësuesit e organizatave që merren me çështjet e sigurisë⁴⁶.

Është e qartë se sektori privat i sigurisë në Kosovë ka nevojë për përmirësim. Pjesa në vijim jep disa rekomandime për këtë qëllim.

6. Rekomandime për Përmirësimin e Sektorit të Sigurisë Private në Kosovë

Rekomandimet që do t'i cekim në vijim, janë shpesh të vërejtura për të përmirësuar gjendjen e sigurisë private në Kosovë.

Shumica e ofruesve privat të sigurisë, në përgjithësi, janë të pajisur me aftësitë bazë për kryerjen e detyrave në lidhje me punët e tyre. Andaj, ne rekomandojmë që punonjësit e kompanive private të sigurisë të kenë një vazhdimësi të trajnimeve të avancuara, si në bashkëpunim me agjencitë e zbatimit të ligjit në Kosovë, ashtu edhe me kompanitë private të sigurisë ndërkombëtare. Ka nevojë të veçantë të identifikimit dhe klasifikimit të personelit të

⁴⁵ GSDRC Applied Knowledge Services. (p.d.). Security Sector Reform. Marrë nga <http://www.gsdrc.org/go/topic-guides/security-sector-reform/private-military-companies>.

⁴⁶ Personat e palicencuar kryejnë shërbime të sigurisë në Kosovë. (2014, Tetor 24). *Portali KOHAnet*. Marrë nga <http://koha.net/?id=27&l=30647>.

sigurisë sipas trajnimeve të ndërmarra, për të ndihmuar ata në vendosjen e vendeve të punës që ata specializohen. Ekziston gjithashtu nevoja edhe për Qeverinë që të formoj një akademi të specializuar të sigurisë, për ofrimin e trajnimeve të avancuara të rojeve private, teknike, si dhe aftësive të tjera. Lehtësimi do të ishte i rëndësishëm për shkak të faktit se shumica e njerëzve të punësuar në industrinë e sigurisë private, nuk janë në gjendje të paguajnë trajnimet e tyre. Nga ana tjetër, ekziston një nevojë për trajnim rreth sigurisë e cila do të ishte e detyrueshme për shkak të rritjes së perceptimit të kërcënimit dhe në pajtim me avancimet teknologjike që grupet kriminale kanë arritur.

Përveç kësaj, shumica e kompanive private të sigurisë nuk janë të prirë që të reklamojnë fitimin dhe numrin e personelit të tyre. Lidhur me këtë, mendim të ngjashëm ka edhe hulumtimi i realizuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë⁴⁷, ku ndër të tjera thuhet “shkelja serioze e të drejtave të njeriut brenda kompanive private të sigurisë, nuk respektohet ligji për punësim dhe një pjesë e madhe e aktiviteteve dhe personelit nuk i raportohet aparatit zyrtar”.

Të zgjidhin problemin e konfliktit të interesit, e që është, punësimi i zyrtarëve të agjencive të zbatimit të ligjit në Kosovë në sektorin privat të sigurisë, duke futur një ndalim të qartë ligjor për angazhimin e zyrtarëve të tillë nga kompanitë private të sigurisë.

Të përcaktojnë qartë kriteret për dhënien e licencave për personat juridik, sipërmarrësit dhe personat fizikë, sidomos në aspektin e verifikimit të së kaluarës dhe kontrollit të duhur të sigurisë.

Njëkohësisht të merren masa nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës, që kompanitë private të sigurisë që operojnë brenda territorit të Kosovës, veçanërisht në pjesën veriore, të regjistrojnë biznesin e tyre dhe të veprojnë konform ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

Të përforcojnë në masë më të madhe bashkëpunimin me policinë, kur është fjala për veprimtaritë kundërligjore dhe krimet që përfshijnë fushëveprimtaritë e mbrojtura nga kompanitë private të sigurisë.

Rritja e kriterëve për kompanitë private të sigurisë që ruajnë objektet shtetërore. Në kryerjen e detyrave që lidhen me ruajtjen e objektet e rëndësishme shtetërore të infrastrukturës, të punësuarit nuk janë të detyruar të kalojnë nëpër ndonjë trajnim të specializuar, andaj, lidhur me përgjegjësinë e lartë që kanë për ruajtjen e këtyre objekteve, ne rekomandojmë që punonjësit e kompanive private të sigurisë të kryejnë trajnime më të specializuara, për shkak të ndjeshmërisë së vendit të punës.

Të miratojnë masa për të parandaluar konfliktet e interesit, si një mjet i veçantë anti-korrupsion. Rritja e pagave të punonjësve të kompanive private të sigurisë, do të ishte një masë parandaluese për infiltrimin e këtyre punonjësve në aktivitete të ndryshme kundër ligjore, dhe disiplina në punë do të ishte e nivelit më profesional.

Këto rekomandime sigurisht se nuk janë të mjaftueshme që brenda natës të rregullohen praktikatat e kompanive private të sigurisë në Kosovë, që nga lufta e fundit, po këto do të sigurojnë disa praktika të mira, të ngjashme me ato të shteteve të BE-së.

7. Përfundim

Sektori Privat i Sigurisë në Kosovë, mund të themi se ka filluar arritjen e pjekurisë në aspektin e vëllimit dhe shumëllojshmërisë së shërbimeve të ofruara. KPS-të janë të pranishme në shumë fusha të drejtësisë dhe punëve të brendshme, si në mbrojtjen e objekteve me rëndësi

⁴⁷ Qehaja, F., Vrajolli, M., & Perteshi, S. (2009). vepër e cit.. Qendra Kosova për Studime të Sigurisë (QKSS), Prishtinë, f. 8.

të veçantë, pronave publike dhe private, mbrojtjen e jetës së njerëzve si dhe në mbrojtjen e pasurisë apo ato të transportit të parave të gatshme.

Analiza e gjendjes së punëve në industrinë private të sigurisë në Kosovë, ka konfirmuar një përshtypje se kjo industri nuk është e rregulluar mirë dhe se ka parregullsi të shumta që përfshijnë një mospërfillje dhe shkelje të ligjeve dhe rregulloreve, por edhe mosrespektim të të drejtave të punëtorëve në këtë sektor.

Edhe pse Industria Private e Sigurisë në Kosovë ka nevojë për reforma të mëtutjeshme, rezultatet e cekura më lartë mund të shërbejnë për të ndihmuar një agjendë proaktive për reforma, për të përmirësuar ligjin në përputhje me kompanitë private të sigurisë ndërkombëtare, duke maksimizuar stimuj dhe zbutje të rreziqeve të identifikuara më lartë.

Gjithashtu, përveç mekanizmave formal të brendshëm dhe të jashtëm, që janë të thirrur për të mbikëqyrur punën e kompanive private të sigurisë, siç janë kontrolli hierarkik, kontrolli nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme, rol të rëndësishëm këtu duhet të luajnë edhe mekanizmat e kontrollit joformal të brendshëm dhe të jashtëm, siç janë vetëkontrolli, kontrolli interpersonal (kur kolegu kontrollon kolegun), mediumet, organizatat joqeveritare dhe partitë politike. Për të pasur më të qartë këtë që e potencuam, mekanizmat formal janë ato mekanizma që janë të ngarkuar ligjërisht për të ushtruar kontroll, kurse joformal janë ato mekanizma që nuk janë të detyruar me ligj të ushtrojnë kontroll. Mendojmë se nëse do të bëhej një kontroll më i suksesshëm në këtë drejtim, edhe puna e kompanive private të sigurisë në Kosovë do të sillte rezultate më të mira, më profesionale dhe puna do të ishte më llogaridhënëse.

8. Conclusion

Private Security Sector in Kosovo, we can say that it has begun reaching maturity in terms of volume and variety of services offered. Private Security Companies are present in many fields of justice and internal affairs, as in the protection of important facilities, public and private property, the protection of human life and protection of property and transport of money.

Analysis of the situation of affairs in the private security industry in Kosovo, confirmed the impression that the industry is not well regulated and that has numerous irregularities involving a disregard and violation of laws and regulations, but also not respecting the rights of workers in this sector.

Although the private security industry in Kosovo needs further reform, the results above can be used to help a proactive agenda for reform, to improve the law in accordance with international private security companies, maximizing incentives and mitigation the risks identified above.

Also, in addition to the formal mechanisms of internal and external, who are called to supervise the work of private security companies, such as hierarchical control, control by Ministry of Internal Affairs, and important role here should be played by the mechanism of informal and external control, such as self-control, interpersonal control (when colleagues controls colleague), the media, non-governmental organizations and political parties. To clear this furthermore, formal mechanisms are those mechanisms that are legally charged to exert control, and informal mechanisms are those that are not required by law to exercise control. We think that if it becomes more successful control in this regard, the work of private security companies in Kosovo would deliver better results, more professional and the work will be more accountable.

9. Bibliografia

1. Ahić, J., (2008). *“Sistemet e Sigurisë Private”*. Sarajevë-Prishtinë.
2. Briscoe, A., & Price, M., (2011). *“Kosovo’s new map of power: governance and crime in the wake of independence”*. Netherlands Institute of International Relations, The Hague.
3. Holmqvist, C., (2005). *“Private Security Companies: The Case for Regulation”*. Stockholm International Peace Research Institute. SRI Policy Paper Nr. 9.
4. Qehaja, F., Vrajolli, M., & Perteshi, S. (2009), *“Kompanitë Private të Sigurisë në Kosovë”*. Qendra Kosova për Studime të Sigurisë (QKSS), Prishtinë.
5. Qehaja, R., & Kosumi, K. (p.d). *Procesi i demobilizimit dhe integritit të ish pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare – perspektiva e Kosovës*.
6. Tzifakis, N., (2012). *“Contracting out to Private Military and Security Companies”*. Centre for European Studies.
7. Lilly, D., (200). *“The privatization of security and peace building: a framework for action”*. International Alert, London.
8. Qeveria e Republikës së Kosovës. (2013, Dhjetor 19). *Rregullore (QRK) Nr. 36/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Ministrisë së Punëve të Brendshme*.
9. Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2012). *Ligji Nr.04/L-076 për Policinë*.
10. Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2008). *Ligji Nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës*.
11. Kuvendi i Republikës së Kosovës. (p.d.). *Projektligji Nr. 04/L-275 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë Forcat e Armatosura të Kosovës*.
12. Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2011, Qershor 23). *Ligji Nr. 04/L-004 për Shërbimet Private të Sigurisë*.
13. Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës. (2010, Prill 16). *Rregullore Nr. 04/2010 për Policinë e FSK-së*.
14. Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës. (2010). *Ngritja, sfidat dhe sukseset e FSK së. Zyra për Marrëdhënie me Publikun*.
15. Rezoluta e Këshillit të Kombeve të Bashkuara S/RES/1244 (1999).
16. UNMIK/RREG/2005/54. (2005, Dhjetor 20). *Rregullore nr. 2005/54 mbi kornizën dhe parimet drejtuese të Shërbimit Policor të Kosovës*.
17. UNMIK. (1999, Shtator 20). *Rregullore Nr. 1999/8 Për Themelimin e Trupave Mbrojtëse të Kosovës*.
18. EULEX Kosovo. (2009, Korrik). *Raporti për Programet (01)*.
19. European Commission. (2014). *Kosovo Progress Report*.
20. Çështje të Sigurisë. (2008). *Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim*. Nr. 7.
21. Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ) dhe Instituti për Studime të Avancuara GAP. (2012, Mars). *Buxheti i Policisë së Kosovës - nevojat për buxhet shtesë dhe planifikim më të mirë financiar*.
22. Crisis Group Europe Report Nr. 204. (2010, Maj 19). *The Rule of Law in Independent Kosovo*.
23. Private Military Companies. (2006). DCAF - The Geneva Centre for the Democratic Control of Armed Forces.
24. Riorganizohen Njësitë Elite. (2012, Janar 02). *Gazeta Jeta në Kosovë*.
25. Paga minimale i bën të vuajnë punëtorët e sigurimit fizik. (2014, Shkurt 18). *Gazeta Bota Sot*.
26. Të gjithë të atakuar nga hajnat. (2015, Prill 26). *Portali Telegrafi*.
27. Sot, 15 vjet nga themelimi i TMK-së, Kosova ende pa ushtri. (2014, Nëntor 19). *Portali Telegrafi*.

28. Ligji për FAK-un pret 2/3 e votave, në veri vetëm me leje të NATO-s. (2015, Prill 01). *Gazeta Express*.
29. Personat e palicencuar kryejnë shërbime të sigurisë në Kosovë. (2014, Tetor 24). Portali KOHAnet.
30. Policia e Kosovës. www.kosovopolice.com.
31. UNMIK Mandate – United Nations Interim Administration Mission in Kosovo.
32. NATO's role in Kosovo. (2015, Mars 24). Faqja zyrtare e NATO-s.
33. GSDRC Applied Knowledge Services. (p.d.). Security Sector Reform.